

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.03.2022*

Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore. Bazuar në nenin 166, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse. Bazuar në nenin 33, shkronja “g” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhore nr. 19, me vendimin nr. 111, datë 7.3.2022, ka shpallur fitues për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie të Bashkisë Dibër, zotin Rahim Petrit Spahiu, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Në relacion do të ishin më të rëndësishme disa të dhëna që kanë të bëjnë me faktin në se qëndron apo jo... tabelat e rezultatit janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët?!

Z. Y. Merkaj: Nuk ka vërejtje, të gjithë anëtarët e KZAZ-së kanë nënshkruar.

Z. I. Celibashi: E njëjta situatë është dhe për tabelat e rezultateve për çdo qendër votimi? Edhe nga verifikimi i rezultatit të çdo qendre votimi me tabelën përmbledhëse nuk kemi ndonjë mospërputhje, ndonjë diferencë?!

Z. Y. Merkaj: Jo nuk ka mospërputhje.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive? Kemi diçka?! Nuk kemi! Dakord!

Bazuar në nenin 2, pika 18, shkronja “b”, nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 33, shkronja “g” dhe nenin 166, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.9.03.2022*

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Dibër, Qarku Dibër, zotit Rahim Petrit Spahiu, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda njëzet e katër orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 131

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 9.03.2022*

Rustem Shera, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Vendimi i KZAZ-së është marrë nga të shtatë anëtarët të cilët kanë nënshkruar. Gjithashtu nga krahasimi i tabelave të përfshira në vendimin e KZAZ-së me tabelat përmbledhëse të plotësuara nga grupi i numërimit, nuk rezultoi diferencë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive? Nuk kemi! Dakord!

Bazuar në nenin 2, pika 18, shkronja “b”, nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 33, shkronja “g” dhe nenit 166, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

1. Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, zotit Blerim Rustem Shera, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda njëzet e katër orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 132

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



9.03.2022
Ora 12:14

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë,
Oarku Tiranë, zotit Edison Selman Molla, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar
bashkie të datës 6 Mars 2022”.*


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta**
- **Parti Politike:** **Shtëpia e Lirisë (A. Kaziaj)**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Në datën 6 Mars 2022”, në Bashkinë Rrogozhinë u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie. Në referim të përcaktimit të nenit 2, pika 18, shkronja “b” të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore. Bazuar në nenin 166, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse. Bazuar në nenin 33, shkronja “g” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhore nr. 43, me vendimin nr. 232, datë 7.3.2022, ka shpallur fitues për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie në Bashkinë Rrogozhinë, zotin Edison Selman Memolla, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Vendimi i KZAZ-së është nënshkruar nga të shtatë anëtarët.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.9.03.2022*

Gjithashtu nga krahasimi i tabelave të përfshira në vendimin nr. 232 të KZAZ-së me tabelat e plotësuara për çdo qendër votimi nga grupi i numërimit, nuk rezultoi diferencë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive? Nuk kemi diskutime! Atëherë, bazuar në nenet 2, pika 18, shkronja “b”, 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 33, shkronja “g” dhe nenit 166, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, zotit Edison Selman Memolla, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda njëzet e katër orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Çështje të tjera në rendin e ditës nuk kemi?!

Z. Y. Merkaç: Për tre bashkitë e tjera po bëhet verifikimi, nga administrata e KQZ-së, për të parë në qoftë se janë përfshirë apo jo të gjitha qendrat e votimit, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit, seanca mbyllet!

Z. A. Kaziqaj, përfaqësues i Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”: Kisha vetëm diçka të vogël. Meqenëse na jepet mundësia dhe tashmë ka përfunduar procesi zgjedhor. Pavarësisht tabelave që nuk janë për tre bashkitë e tjera, do të doja të falenderoja ju si Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe gjithë KQZ-në për punën e palodhur dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.9.03.2022*

arritjen e bërjes së mundur dhe pa problem të këtij procesi zgjedhor. Proces që pa dyshim ka qenë intensiv për shkak të kohës së shkurtër në të cilën janë zhvilluar këto zgjedhje. Po më jepni mundësinë të falenderoj mbështetësit e Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, të cilët me mund shumë të madh kanë dhënë kontributin e tyre, por dhe gjithë personat e tjerë që janë marrë me organizimin e procesit. Ju faleminderit të gjithëve!

Z. I. Celibashi: Faleminderit dhe ju për të gjithë angazhimin në përputhje me parashikimet e kodit dhe gjithë subjekteve zgjedhore të cilët kodi i ka ngarkuar me përgjegjësinë e administrimit të këtij procesi zgjedhor! Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Vendimi nr. 133

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

